

VENDIM
Nr.1286, datë 23.12.2009

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.781, DATË 14.11.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KARAKTERISTIKAT TEKNIKE E FUNKSIONALE TË
PAJISJEVE FISKALE, TË SISTEMIT TË INTEGRUAR TË KOMPJUTERIZUAR PËR
TRANSFERIMET PERIODIKE, AUTOMATIKE, TË DEKLARIMEVE FINANCIARE,
SISTEMIT TË KOMUNIKIMIT, PËR PROCEDURËN E DOKUMENTACIONIN PËR
MIRATIMIN E TYRE DHE PËR KRITERET PËR PAJISJEN, ME AUTORIZIM, TË
SHOQËRIVE, TË AUTORIZUARA PËR OFRIMIN E PAJISJEVE FISKALE”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas shkronjës “ç” të pikës 38 të vendimit nr.781, datë 14.11.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet shkronja “d”, me këtë përmbajtje:

“d) 15 ditë pas regjistrimit, të gjithë personat e tatueshëm, që bëhen subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha